



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
Komisioni Institucional i Zgjedhjeve

V E N D I M

Nr. 40, Datë 10 / 05 /2024

“Për zgjedhjen e 2 (dy) anëtarëve – nga personeli akademik, në vendet vakante, të Komisionit të Zgjedhjeve të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, të UT-së”

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës”, Kreu II, neni 7, pikat 1 dhe 2, si dhe vendimit nr. 33, Datë 07/05/2024 të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve, të UT-së, në mbledhjen e datës 10.05.2024, KIZ i UT-së

V E N D O S I:

1. Plotësimin e 1 (një) vendi vakant për anëtar - përfaqësues i stafit akademik me kohë të plotë nga Departamenti i Gjuhës Angleze, në Komisionin e Zgjedhjeve të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, të UT, me anëtarin e zgjedhur Znj. Kristina Sheperi.
2. Plotësimin e 1 (një) vendi vakant për anëtar - përfaqësues i stafit akademik me kohë të plotë nga Departamenti i Gjuhës Spanjolle, në Komisionin e Zgjedhjeve të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, të UT, me anëtarin e zgjedhur Znj. Andia Dani.
3. Vendimi të dërgohet për zbatim në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, të UT-së.
4. Ky vendim, të publikohet në mjedise të dukshme të Fakultetit dhe në faqen e tij zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të UT-së.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

- | | | |
|---------------------|-----------|----------|
| 1. Leticja Gusho | (Kryetar) | |
| 2. Alnida Koroshi | (Anëtar) | |
| 3. Arjan Tushaj | -//- | (mungon) |
| 4. Eljon Doçe | -//- | |
| 5. Etlon Peppo | -//- | |
| 6. Shaniko Allajbeu | -//- | |
| 7. Dhurata Saraçi | -//- | |

